

Arbër HADRI

**PERIODIZIMI I QËNDRIMIT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË
AMERIKËS NDAJ ÇËSHTJES SË KOSOVËS**

Abstrakt:

Rëndësia e këtij punimi qëndron në periodizimin historiografik të politikës së jashtme amerikane dhe të rolit të saj vendimtar në çështjen e Kosovës duke ndriçuar ndikimin e kësaj politike në historinë bashkëkohore të Kosovës dhe të kombit shqiptar. Ky studim argumenton se angazhimi i Shteteve të Bashkuara ka qenë thelbësor në çlirimin dhe shtetndërtimin e Kosovës, si dhe në integrimin e saj në rendin ndërkombëtar. Rezultatet e studimit tregojnë se ndryshimet në politikën amerikane ndaj Kosovës kanë reflektuar dinamika të reja globale, duke përfshirë përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe përpjekjet për rikonfigurimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky angazhim kulmoi me shpëtimin e popullit shqiptar gjatë luftës në Kosovë dhe mbështetjen që çoi në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Në aspektin metodologjik, studimi mbështetet në një analizë të strukturuar kronologjike, e cila shqyrton procesin e zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së, të organizuar në dhjetë faza kryesore bazuar në kritere dhe veçori të caktuara. Ky periodizim shqyrton ndryshimet në qasjen dhe intensitetin e politikës amerikane në kontekstin e krijimit të rendit të ri botëror në periudha të ndryshme, duke filluar nga Konferenca e Paqes në Paris (1919-1920) deri te mbikëqyrja amerikane në procesin e shtetndërtimit dhe integrimi euroatlantike të Kosovës dhe kombit shqiptar. Në përfundim, punimi nxjerr në pah rolin e pazëvendësueshëm të Shteteve të Bashkuara në historinë moderne të Kosovës, duke theksuar se periudhat pas përfundimit të Luftës së Ftohtë përfaqësojnë momentet më kritike të politikës amerikane ndaj

Kosovës. Këto periudha ofrojnë një kuptim të thellë për ndikimin e SHBA-së në formësimin e ardhmërisë së Kosovës dhe për integrimin e saj në skenën ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: *Politika e jashtme e SHBA-së, Kosova, periodizim historiografik, marrëdhënie ndërkombëtare, shtetndërtim.*

Politika amerikane ndaj çështjes së Kosovës ka luajtur një rol vendimtar në historinë bashkëkohore të Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi. Marrëdhëniet historike ndërmjet shqiptarëve dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe përfshirja amerikane në çështjen shqiptare, përfshirë Kosovën, përshkojnë një rrugëtim të gjatë që nga Konferenca e Paqes në Paris më 1919-1920, ku u mbrojtën të drejtat e shtetit shqiptar e deri te rigjallërimi i interesimit amerikan për Kosovën pas përfundimit të Luftës së Ftohtë në vitin 1989.

Ky angazhim kulmoi me shpëtimin e popullit shqiptar gjatë luftës në Kosovë dhe përkrahjen e vazhdueshme që çoi në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, duke qenë nën mbështetjen dhe udhëheqjen e SHBA-së. Periodizimi¹ i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së, veçanërisht roli i politikës amerikane në procesin e çlirimit dhe shtetndërtimit të Kosovës, ndahet në dhjetë faza kryesore. Këto faza reflektojnë përpjekjet historike për liri dhe pavarësi, duke nënvizuar rëndësinë e mbështetjes amerikane në sendërtimin e shtetit shqiptar dhe të Kosovës, si dhe integrimin e tyre në skenën ndërkombëtare, e ato janë:

- Vrojtimi izolues 1912-1918;
- Shpëtimi i qenies së shtetit shqiptar 1919-1920;
- Marrëdhëniet ndërshtetërore 1921-1939;
- Qëndrimi amerikan ndaj çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- Rendi i ri botëror - Lufta e Ftohtë;
- Përfundimi i Luftës së Ftohtë: Kosova në orbitën e politikës amerikane 1989-1997;

¹ Për shkak të karakterit konceptual të periodizimit dhe paraqitjen e konkluzioneve historike, lidhur me shtresimin historiografik të qëndrimit të SHBA-së ndaj Kosovës, nuk përdoren referenca.

- Lufta në Kosovë: Shpëtimi 1998-1999;
- Bashkëqeverisja: Protoktori i OKB-së në Kosovë 1999-2004;
- Drejt Pavarësisë së Kosovës 2005-2008;
- Roli dhe mbikëqyrja amerikane në shtetndërtimin e Kosovës dhe të integritimeve euroatlantike.

Karakteristika kryesore që lidh periudhat historike të përfshira në këtë studim është ndryshimi i qasjes dhe i intensitetit të politikës së jashtme amerikane, i cili ndikohej nga krijimi i rendit të ri botëror në periudha të ndryshme. Ky ndryshim është evidentuar në kontekste të tilla, si rikonfigurimi i marrëdhënieve globale pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe mbajtjes së Konferencës së Paqes në Paris, pas Luftës së Dytë Botërore me Konferencën e Jaltës dhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, kur SHBA-ja u shfaq si superfuqia e vetme globale.

Duke marrë parasysh periudhën kohore të analizuar dhe objektivin e këtij studimi, fokusi kryesor do të përqendrohet në ngjarjet kyçe dhe periudhat pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Këto aspekte do të trajtohen në detaje në kapitujt vijues, duke theksuar momentet më kritike që kanë ndikuar në politikën amerikane ndaj Kosovës dhe rolit të saj në rikonfigurimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Vrojtimi izolues: fillimi i shekullit XX-1918. Në këtë periudhë kohore politika e jashtme amerikane është karakterizuar nga një qëndrim izolacionist ndaj zhvillimeve globale, veçanërisht në kontinentet e tjera dhe në Evropë. Ky izolim politik dominoi historinë e hershme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës deri në shekullin e njëzet, kur roli i saj në skenën ndërkombëtare ishte dytësor. Vetëm pas fillimit të Luftës së Parë Botërore në vitin 1914 dhe përfshirjes më aktive të SHBA-së në çështjet globale filloi të shfaqej më qartë angazhimi i saj domethënës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë kontekst interesi amerikan për Evropën Juglindore dhe Shqipërinë kishte kryesisht një natyrë informative për përcaktime gjeostrategjike, duke u fokusuar në definimin e interesave të saj globale.

Fillimisht, interesimi amerikan për çështjet botërore u shfaq përmes idesë së presidentit Wilson për krijimin e Ligës për Zbatimin e Paqes, një organizatë ndërkombëtare që do të përbëhej nga shtete sovraane. Kjo organizatë synonte të vendoste rregulla ndërkombëtare dhe të aplikonte

sanksione ekonomike dhe ushtarake ndaj shteteve që refuzonin zgjidhjen paqësore të konflikteve. Në kontekstin e temës që trajtojmë, veçanërisht në lidhje me Konferencën e Paqes në Paris, një rëndësi të veçantë kanë fjalimet dhe programi me Katërmbëdhjetë pika i presidentit Woodrow Wilson. Po aq të rëndësishme janë edhe përgatitjet dhe qëndrimet e Komisionit Përgatitor Amerikan, i njohur si “Inquiry,” që ofroi rekomandime për Ballkanin dhe çështjen shqiptare. Këto rekomandime luajtën një rol të rëndësishëm në përcaktimin e politikave amerikane në prag të Konferencës së Paqes.

Pozita e çështjes shqiptare, përfshirë atë të Kosovës, në prag të Konferencës së Paqes ishte tejet e pafavorshme, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Një pjesë e madhe e territorit shqiptar ishte nën kontroll të huaj, ndërsa shteti shqiptar nuk kishte luajtur një rol aktiv në krah të aleatëve gjatë Luftës së Parë Botërore. Si rezultat, pozicioni i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare ishte i dobët dhe i pasigurt.

Shteti shqiptar ende nuk ishte konsoliduar në një formë të qëndrueshme, që do të siguronte stabilitet politik dhe forcë ushtarake, pasi stuhia e ngjarjeve të Luftës së Parë Botërore e kishte zhytur atë në një situatë jashtë kontrollit të vet. Përveç kësaj sfide madhore, kombi shqiptar përballëj me rrezikun e ndarjes territoriale dhe kërcënimin për ekzistencën e vet shtetit shqiptar. Këta faktorë krijuan një situatë të brishtë dhe komplekse, duke e vendosur çështjen shqiptare në një pozitë tejet të vështirë përballë konstelacioneve ndërkombëtare të asaj kohe.

Faza e Dytë: shpëtimi i qenies së shtetit shqiptar 1919-1920, shënon hyrjen në derë të madhe të politikës së jashtme të SHBA-së në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe fundin e izolacionizmit e fillimin e progresizmit në politikën e jashtme amerikane.

Kjo periudhë shquhet me fillimin dhe sendërtimin e marrëdhënieve të shkëlqyera të SHBA-së dhe kombit shqiptar, respektivisht të rolit udhëheqës të saj në shtetformimin e shqiptarëve dhe qëndrimin e një ndër burrshtetasit më të mëdhenj botërorë të shekullit XX, presidentit të SHBA-së Woodrow Wilson. Qëndrimi i tij mbeti i vetmuar në rreshtimin për mbrojtjen dhe mbi jetimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe shpëtimin e qenies së shtetit të ri shqiptar. Kjo periudhë, që përkoji me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, ishte tepër sfiduese për shtetin e ri shqiptar, i cili nuk arriti të konsolidohej

për shkak të fillimit të luftës dhe presioneve të vazhdueshme nga shtetet fqinje. Këto shtete synonin shpërbërjen e Shqipërisë, duke kërcënuar sovranitetin e saj territorial dhe duke penguar stabilizimin e saj politik.

Kosova dhe territoret e tjera të banuara nga shqiptarët, të cilat ishin ndarë padrejtësisht në Konferencën e Londrës, u anashkaluan që në fillim gjatë trajtimeve në Konferencën e Paqes.

Qëndrimi i politikës së SHBA-së ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris karakterizohet nga tri etapa të rëndësishme të krijimit të politikës amerikane kundruall saj: 1. periudha para fillimit të Konferencës së Paqes, që shquhet nga qëndrime joelokuente dhe ende jo të prera të administratës amerikane ndaj çështjes shqiptare, por me parime të përgjithshme ndërkombëtare të vendosura nga presidenti Wilson; 2. etapa e mbrojtjes së qenies së shtetit shqiptar nga ana e presidentit Wilson dhe e delegacionit negociator të SHBA-së gjatë gjithë punimeve të Konferencës së Paqes dhe të Konferencës së Ambasadorëve e deri me përfundimin e mandatit presidencial të Wilson-it; si dhe 3. periudha pasvillsoniane me ripozionimin e stepur të politikës së administratës së re amerikane dhe hezitimin fillestar të saj për pranimin e shtetit shqiptar.

Në këtë udhëkryq historik për popullin shqiptar, politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e përfaqësuar nga presidenti Woodrow Wilson, luajti një rol shpëtimtar. Presidenti Wilson kundërshtoi me vendosmëri planin për ndarjen treshe të Shqipërisë, një qëndrim i vazhdueshëm i shteteve fqinje dhe Fuqive të tjera të Mëdha, të cilat synonin zgjidhjen e çështjes së Adriatikut nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes së Londrës. Përkrahja e tij e palëkundur e ripërtëritjes shtetërore të Shqipërisë gjatë Konferencës së Paqes hodhi themelet e forta për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në vijim.

Faza e Tretë: marrëdhëniet ndërshtetërore në themelim 1921-1939, përfshinë periudhën e ripërtëritjes së shtetit shqiptar, konstituimin e sovranitetit të saj shtetëror, bisedimet e ndërsjella me administratën amerikane për bashkëpunimin ekonomik, pranimin e qeverisë së Shqipërisë nga ana e SHBA-së dhe themelimin e marrëdhënieve të rregullta diplomatike, ekonomike, kulturore dhe humanitare. Kosova dhe territoret e tjera të populluara me shqiptarë në kohën e Mbretërisë Jugosllave janë jashtë domenit të interesimit direkt amerikan, përkundër shkeljeve drastike të të drejtave

elementare të popullit shqiptar. Kjo meqë politika e jashtme amerikane ndërmjet dy luftërave botërore kishte kthyer karakterin e stepur në marrëdhëniet politike globale, duke dominuar përfaqësimi i interesave të saj puro ekonomike. Përfshirja amerikane më domethënëse në planin botëror qëndron pezull në këtë kohë dhe pa angazhim direkt në trajtimin e interesave të saj skajore gjeostrategjike deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, kur fillojnë të preken interesat vitale të saj.

Qëndrimi amerikan ndaj çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ndaj Evropës në përgjithësi ndryshoi ndjeshëm me përfshirjen e drejtpërdrejtë të SHBA-së në konflikt dhe mbështetjen për Aleancën Antifashiste. Në këtë periudhë roli i SHBA-së u konsolidua si një faktor përcaktues në zhvillimet globale si në aspektin politik dhe ushtarak, ashtu edhe në ruajtjen e primatit ekonomik përmes furnizimit me armë të avancuara për aleatët.

Në këtë kohë shqiptarët në pjesën më të madhe ishin në një shtet të vetëm, por të pushtuar nga regjimi fashist italian dhe më pas nga nazistët gjermanë, me një qeveri kuislinge të instaluar. Kjo periudhë e shkurtër la pasojë të rënda dhe pati ndikim negativ në rrethanat e pasluftës. Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore u zhvilluan brenda këtij konteksti lufte dhe në kushte të veçanta historike.

Përparimi i forcave amerikane dhe aleate në Evropë, së bashku me avancimin e sovjetikëve në Evropën Qendrore dhe Juglindore, çoi në shkatërrimin e nazizmit dhe krijimin e një rendi të ri botëror. Ky rend u përcaktua në Konferencën e Jaltës, duke vendosur interesat globale midis Fuqive të Mëdha dhe duke çuar më vonë në Luftën e Ftohtë. Në këtë periudhë Kosova dhe Maqedonia, si pjesë të Federatës Jugosllave, u përfshinë fillimisht në bllokun sovjetik, bashkë me Shqipërinë. Kjo situatë kufizoi ndjeshëm ndikimin amerikan në rajonin e Ballkanit në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Periudha e Luftës së Ftohtë: rendi i ri botëror 1945-1989 dhe marrëdhëniet e SHBA-së me shqiptarët në përgjithësi formësohen nën ndikimin e një rendi të ri botëror pas Luftës së Ftohtë, i karakterizuar nga rivaliteti ndërmjet

Shteteve të Bashkuara dhe Bllokut Sino-Sovjetik, dy superfuqive që udhëhoqën këtë periudhë bipolare. Politika e jashtme amerikane karakterizohet me influencë të pjesshme në trevat shqiptare si pasojë e ndarjes së sferës së interesit në konstelacionet ndërkombëtare si dhe në krijimin e balancit të forcave në Evropë ndërmjet dy superfuqive botërore. Kosova, përkundër faktit të vendimit të saj në Konferencën e Bujanit gjatë luftës antifashiste për bashkim në një shtet me Shqipërinë, anashkalohet nga Jugosllavia komuniste në themelim, duke e trajtuar vetëm si një krahinë autonome dhe nën Serbinë Federale.

Për një kohë të shkurtër u shikua mundësia e përfshirjes së saj në kuadër të një Republike të Shqipërisë në kuadër të Koalicionit Federativ Ballkanik me Jugosllavinë në krye të saj. Shteti shqiptar u mbërthye në antagonizmat e brendshëm me instalimin e komunizmit, izolimin e skajshëm të tij dhe renditjen përskaaj aleatit të panatyrshëm Bashkimit Sovjetik, që edhe e vuri në pozitë pritjeje e inferioriteti shtetin shqiptar përballë politikës zyrtare të SHBA-së.

Gjatë dhe menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, politika e jashtme amerikane ndaj Shqipërisë ishte e përmbajtur dhe e kufizuar. Ky qëndrim bazohej në të drejtën e Shqipërisë për të qenë një shtet i lirë dhe sovran, për të vendosur të ardhmen dhe formën e saj të qeverisjes, por duke iu përmbajtur parimeve të demokracisë dhe detyrimeve ndërkombëtare të trashëguara. Megjithatë, Shqipëria, ashtu si vendet e tjera të Evropës Lindore dhe të Ballkanit, tashmë kishte hyrë në orbitën e shteteve satelite të Bashkimit Sovjetik. Marrëdhëniet diplomatike formale midis dy vendeve mbetën të ngrira për më shumë se një gjysmëshekulli. Përpjekjet e Shteteve të Bashkuara për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore dhe mbyllja e Misionit Amerikan pasqyronin rrethanat që çuan në pezullimin e marrëdhënieve diplomatike. Ky ngërç vazhdoi pa ndryshime për pesë dekada, deri në transformimin e Shqipërisë në një shoqëri demokratike.

Të njëjtin fat e përjetoi edhe populli shqiptar në ish-Jugosllavi, i cili u nda në disa pjesë në kuadër të njëjësive konstituive dhe periudha e përtëritjes së identitetit të tyre politik, kombëtar e shtetëror do të jetë e mundimshme. Po ashtu kahe tjetër merr edhe trajtimi i këtij regjioni nga politika e jashtme amerikane, me perceptim tjetër të Jugosllavisë, që fillon të hapet ndaj botës

perëndimore dhe Shqipërisë, e cila mbyllet në një izolim ndaj gjithë botës tjetër. Interesimi i SHBA-së për popullin shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi veçanërisht vihet në dukje me ndryshimet kushtetuese në kuadër të Federatës më 1968 dhe 1974, me krijimin e subjektivitetit në ngritje të Autonomisë së gjerë të Kosovës, me të drejta të njëjta si etnitetet e tjera në kuadër të Jugosllavisë Federale. Po ashtu vëmendja amerikane mbi ngjarjet në Kosovë dhe në Jugosllavi do të përqendrohet në periudhën pas vdekjes së Titos, Demonstratave të vitit 1981 dhe fillimin e ngritjes së nacionalizmit serb e ngrirjes së të drejtave të shqiptarëve gjatë viteve të '80-ta dhe shtypjes së popullit shqiptar e diferencimit të inteligjencës në Kosovë, e cila në këtë stad ishte e vetmja lidhje e shpresë për popullin shqiptar. Politika e SHBA-së e cilëson në këtë kohë çështjen e Kosovës si fuqi baroti, e cila mund të shpërthejë në çdo kohë.

Përfundimi i Luftës së Ftohtë: Kosova në orbitën e politikës së jashtme amerikane 1989-1997. Fillimi i procesit të përfundimit të Luftës së Ftohtë çoi në krijimin e parametrave të rinj të politikës ndërkombëtare. Formimi i një rendi të ri botëror dhe ndryshimi i balancave të fuqive në skenën ndërkombëtare së bashku me shkatërrimin e bllokut socialist lindor krijuan mundësi për ruajtjen e shoqërive dhe të ekonomive të shteteve të Evropës Lindore dhe Juglindore. Kjo situatë solli pasiguri për mbijetesën e Jugosllavisë si një shtet i bashkuar i shumë popujve me interesa kombëtare të ndryshme, duke çuar në shpërthimin e luftërave dhe krijimin e një problemi ndërkombëtar, që shënoi një fazë të veçantë historiografike.

Politika amerikane mbante një qëndrim të qartë për Evropën, duke e trajtuar si një aleate me interes të veçantë, duke u angazhuar për ruajtjen e unitetit të saj, parandalimin e mundësive për konflikte dhe promovimin e prosperitetit të përgjithshëm në të gjithë kontinentin. Qëndrimi ndaj Evropës Juglindore ishte i ngjashëm, por me veçoritë e saj, të cilat kërkonin përballimin e një intensifikimi të ri të ngjarjeve pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe fillimit të shpërbërjes dhe konflikteve në Jugosllavi. Kjo situatë solli befasi për Bashkësinë Ndërkombëtare, e cila mbeti e pasigurt dhe e ngathët në përcaktimin e qëndrimit të duhur politik ndaj këtyre ngjarjeve gjithashtu për shkak të rikrijimit të marrëdhënieve në skenën globale.

Në këtë periudhë Serbia ndërmori aktin joligjor të suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës dhe instaloi një sistem aparteidi, një veprim që politika amerikane e kundërshtoi dhe nuk e përkrahu gjatë gjithë kohës së zbatimit të tij. Qëndrimi amerikan ishte mbështetës për organizimin politik në Kosovë dhe Lëvizjen Paqësore, por në këtë fazë SHBA-ja nuk mbështeti në mënyrë të drejtpërdrejtë pavarësinë e Kosovës, e cila u konfirmua me referendumin gjithëpopullor, por kërkonte rikthimin e të drejtave të plota të shqiptarëve dhe autonominë substanciale të Kosovës brenda Jugosllavisë Federale. Serbia mbeti nën presion të vazhdueshëm për të ndaluar instalimin dhe zbatimin e aparteidit, një shkelje të të drejtave të njeriut të paprecedent, që ndodhte në zemër të Evropës.

Politika e jashtme amerikane gjatë kësaj periudhe mbajti një qëndrim për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Kosovë, duke përfshirë parandalimin e shpërthimit të luftës përmes aplikimit të “Vijës së kuqe” dhe ndalimit të përshkallëzimit të luftës në Bosnjë, si dhe duke dërguar trupat amerikane në terren. Po ashtu, me fillimin e konflikteve të armatosura, SHBA-ja intensifikoi përpjekjet diplomatike të shoqëruara me kërcënime ushtarake.

Anashkalimi i çështjes së Kosovës në Marrëveshjen e Dejtonit shënoi një ndryshim të rëndësishëm në kursin e lëvizjes kombëtare për liri dhe pavarësi, duke çuar në përdorimin e metodave ushtarake për zgjidhjen e problemit përmes ngritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky zhvillim ndryshoi dinamikën e brendshme të Kosovës dhe ndikoi në përqendrimin ndërkombëtar ndaj situatës në Kosovë. Po ashtu, SHBA-ja luajti një rol kyç në konsolidimin e shtetit shqiptar dhe instalimin e demokracisë në Shqipëri.

Mërgata shqiptaro-amerikane ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në lobimin për mbështetje ndërkombëtare për çështjen e Kosovës, duke qenë zë i Kosovës dhe duke realizuar sensibilizimin ndërkombëtar të çështjes. Kjo arritje ka qenë një hap i rëndësishëm në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë.

Lufta në Kosovë: shpëtimi 1998-1999. Periodizimi i politikës së SHBA-së ndaj çështjes së Kosovës, duke nisur nga kryengritja e përgjithshme në Kosovë në mars të vitit 1998 nën udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës shënon një periudhë të rëndësishme dhe më aktive. Ky moment përfaqëson

një fazë të veçantë, ku SHBA-ja përdori diplomacinë shtrënguese për të mundësuar ripërtëritjen e paqes dhe një marrëveshje të pranueshme nga të dyja palët. Shtetet e Bashkuara ushtruan një presion mbi agresionin serb për të ndaluar mizoritë, për të parandaluar zhvendosjen e popullatës shqiptare, si dhe shpërthimin e katastrofave humanitare e spastrimin etnik. Këto rrethana detyruan politikën amerikane që të merrte një qëndrim më të ashpër, duke përqendruar vëmendjen në mundësinë e ndërhyrjes ushtarake në Kosovë.

Ky planifikim përfshinte sulmet ajrore të NATO-s kundër Serbisë, të udhëhequra nga SHBA-ja, të cilat u intensifikuan gjatë muajve shtator dhe tetor 1998, pas marrjes së “Urdhrit të Aktivizimit” nga NATO, por u pezulluan pas nënshkrimit të “Marrëveshjes së Tetorit 1998” ndërmjet Holbrukut dhe Millosheviqit.

Këto zhvillime krijuan një periudhë historike që mund të ndahet në tri etapa: mars 1998 - tetor 1998; tetor 1998 - janar 1999; dhe janar - mars 1999. Etapa e dytë, ajo e armëpushimit, shënon një periudhë të shkurtër ndërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Tetorit 1998 dhe shkeljes së saj pas masakrës së Reçakut, më 15 janar 1999. Kjo masakër shkaktoi reagime të fuqishme ndërkombëtare, duke i shtyrë Shtetet e Bashkuara dhe komunitetin ndërkombëtar të kërkojnë një veprim të menjëhershëm për të ndaluar mizoritë serbe dhe për të arritur një marrëveshje paqësore për Kosovën.

Etapa e tretë e politikës amerikane përfshin organizimin e “Konferencës së Rambujesë” në shkurt 1999 dhe “Bisedimeve të Parisit” në mars 1999, përpjekje që synonin arritjen e një zgjidhjeje politike. Megjithatë, përpjekjet për marrëveshje përfunduan me nënshkrimin e njëanshëm të “Marrëveshjes së Rambujesë” nga delegacioni kosovar dhe refuzimin e Millosheviqit, që shkaktoi fillimin e bombardimeve ajrore të NATO-s kundër Serbisë dhe Jugosllavisë.

Ndërhyrja ushtarake 78-ditore e NATO-s, e udhëhequr nga SHBA-ja, si dhe faktori i brendshëm ushtarak i UÇK-së që vepronin në Kosovë, kishin ndikim të drejtpërdrejtë në ndryshimin e fatit historik të Kosovës. Në qershor 1999, me kapitullimin e forcave serbe të Millosheviqit, Kosova fitoi lirinë e saj. Shtetet e Bashkuara nën udhëheqjen e presidentit Bill Clinton realizuan premtimin për të parandaluar një “Bosnjë të dytë” në Evropë dhe u kundërvunë me forcë përpjekjeve të Millosheviqit për të realizuar një

spastrimin etnik ndaj më shumë se një milion shqiptarëve të Kosovës në fund të shekullit XX.

Bashkëqeverisja: Protektorati i KB-së në Kosovë 1999-2004. Kjo periudhë në kontekstin e politikës së jashtme amerikane menjëherë pas luftës në Kosovë përqendrohet në rivendosjen e paqes nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar nëpërmjet Protektoratit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, respektivisht Rezolutës 1244 dhe misionit të sigurisë së NATO-s në Kosovë - KFOR-it, pjesë përbërëse e të cilave ishte një kontingjent i rëndësishëm amerikan. Politika e jashtme amerikane pas luftës në Kosovë përqendrohet në rivendosjen e paqes nën administratën e përkohshme ndërkombëtare nëpërmjet Protektoratit të Kombeve të Bashkuara, në bazë të Rezolutës 1244, si dhe misionit të sigurisë të NATO-s (KFOR), ku një kontingjent i rëndësishëm amerikan ishte pjesë përbërëse e këtij procesi. Kosova në këtë fazë rindërtohet në aspektin material, social, ekonomik e politik. Po ashtu i kushtohet vëmendje stabilitetit në vend, me krijimin e kushteve për themelimin e institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës, të cilat fillimisht bashkëvepronin me bashkësinë ndërkombëtare.

Në këtë periudhë Kosova ishte nën kujdestarinë e SHBA-së për të konsoliduar qëllimet e saj, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e së ardhmes politike. Ky proces “standardet para statusit” ishte shtyrë për një periudhë më të favorshme nga UNMIK-u, pas konsolidimit demokratik të Kosovës. Trazirat e marsit të vitit 2004 shkaktuan një ndryshim të rëndësishëm në skenën e brendshme të Kosovës, duke pasuar me një ndikim negativ në stabilitetin e vendit dhe një kufizim të protektoratit ndërkombëtar. Këto ngjarje gjithashtu nxitën përshpejtimin e procesit për trajtimin e statusit përfundimtar të Kosovës, një çështje që administrata Amerikane e kishte premtuar se do të fillonte ta shqyrtonte gjatë vitit 2005.

Drejt Pavarësisë së Kosovës 2005–2008. Një fazë të posaçme në periodizimin e qëndrimit amerikan ndaj Kosovës e shënon periudha e fillimit të trajtimit të statusit përfundimtar të Kosovës, që u përcaktua në një proces ndërkombëtar. Situata politike në Kosovë kishte filluar të shpërbëhej dhe *status quo*-ja nuk ishte më e qëndrueshme. Ky element ndikoi që politika amerikane dhe ajo ndërkombëtare të përcaktoheshin drejt zgjidhjes së

çështjes së Kosovës. Vullneti i shumicës së popullit në Kosovë nuk mund të mbahej më peng i aspiratave të Serbisë, e cila nuk kishte më forca ushtarake e policore prezente në Kosovë dhe vetë popullata shumicë ushtronte sovranitetin demokratik.

Ky dimension ndikoi në ndryshimin e qasjes së politikës amerikane ndaj Kosovës duke e cilësuar tani zgjidhjen e statusit të saj, që detyrimisht shkonte drejt pavarësisë së saj, si një faktor i sendërtuar dhe i gjenerimit të stabilitetit në Kosovë e rajon. Qëndrimi amerikan gjatë procesit të Negociatave të Vjenës, raportit të Kai Aides dhe dokumentit të Pakos së Ahtisarit, luajti një rol vendimtar dhe udhëheqës në këto procese. SHBA-ja përcaktoi kahen e këtyre negociatave dhe mori një rol kryesor ndërmjetësues veçanërisht në lidhje me strukturat politike të Kosovës për shkak të kontributit të çmuar amerikan në arritjen e lirisë dhe të përkrahjes së vazhdueshme që ofruan. Një qëndrim i përbashkët ndërkombëtar ishte se Kosova duhet ta ketë një pavarësi të kushtëzuar.

Ngecja e këtij procesi në planin ndërkombëtar me inicimin e negociimit të Trojkës, me sabotimin e Rosisë dhe Serbisë, ndikoi që politika e jashtme amerikane në krye me strukturat më të larta politike të shtetit të SHBA-së presidentin Bush, të caktojë një kufizim kohor për përcaktimin e një vendimi ndërkombëtar për të ardhmen e Kosovës, si dhe u shpreh qartazi se statusi i Kosovës nuk mund të shtyhet pakufi dhe se ajo duhet në fund të jetë e pavarur. Si pjesë e këtij përcaktimi të politikës amerikane ishte veprimi udhëheqës i saj në arealin ndërkombëtar për Shpalljen e koordinuar të Pavarësisë së Kosovës më 17.02.2008, rezultat i sakrificës shekullore të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, si dhe i rolit vendimtar dhe të pazëvendësueshëm të SHBA-së.

Roli dhe mbikëqyrja amerikane në shtetndërtimin e Kosovës dhe të integritimeve euroatlantike. Një periudhë e rëndësishme në periodizimin e politikës së jashtme amerikane ndaj Kosovës është ajo pas shpalljes së pavarësisë dhe mbikëqyrjes ndërkombëtare të implementimit të provizioneve të Pakos së Ahtisarit. Këto norma dhe standarde u pranuan dhe u përfshinë në Deklaratën e Pavarësisë dhe kanë shërbyer si udhëzues në rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit në organizatat ndërkombëtare.

Ky qëndrim është i bazuar në parimin se Kosova si një shtet i ri, produkt i vetë politikës së jashtme amerikane, duhet të jetë një histori suksesi, ku investimet e shumta amerikane në fusha të ndryshme - politike, diplomatike, ekonomike, sociale, kulturore dhe ushtarake - duhet të rezultojnë në arritjen e qëllimeve të saj.

Periodizimi i politikës amerikane ndaj Kosovës është thelbësor në kontekstin historiografik, pasi pasqyron zhvillimet kryesore të historisë më të re të Kosovës dhe pozicionin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. Roli amerikan ka qenë jetik gjatë kësaj periudhe për mbijetesën, shpëtimin, lirinë dhe pavarësinë politike të popullit shqiptar në Kosovë.

Arbër HADRI

SUMMARY

**THE PERIODIZATION OF THE UNITED STATES STANCE ON
THE KOSOVO ISSUE**

This paper highlights the historiographical importance of analyzing U.S. foreign policy and its central role in addressing the Kosovo issue, emphasizing its influence on the modern history of Kosovo and the Albanian nation. The study argues that U.S. engagement was instrumental in facilitating Kosovo's liberation, fostering its state-building efforts, and ensuring its integration into the international order.

The findings reveal that shifts in U.S. policy towards Kosovo mirrored global dynamics, particularly the end of the Cold War and the subsequent efforts to reconfigure international relations. This engagement reached its peak with the intervention that safeguarded the Albanian population during the Kosovo War and the sustained support that culminated in Kosovo's declaration of independence.

Methodologically, the study employs a chronologically structured approach to analyze the evolution of U.S.-Kosovo relations, dividing this development into ten distinct phases based on specific criteria and characteristics. This periodization explores the changing approaches and intensities of U.S. foreign policy in the broader context of successive world orders, from the Paris Peace Conference (1919–1920) to American oversight during Kosovo's state-building and Euro-Atlantic integration.

In conclusion, the paper underscores the indispensable role of the United States in shaping Kosovo's modern history. It emphasizes that the post-Cold War period stands out as the most critical phase of U.S. policy towards Kosovo, offering valuable insights into the profound influence of the U.S. in shaping Kosovo's trajectory and its integration into the global arena.